

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pagat e magjistratëve, PS propozon rritje sa 2% e pagës së Presidentit! Rama shkon në Kuvend. Bardh i: Puç kushtetues
ADRESA	https://dosja.al/live-updates/5-interperlanca-dhe-ceshtja-e-pagave-te-magjistrateve-nis-seanca-pl-i514586
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 08:24:23 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 08:15:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	dca81ea09668821aefd6d30e4ff9dd7e3644f7485de11a20912d30e01bea0507
TEKSTI	e4472384b7340998f47a6680bf014237301411a20a2c0707fba21b2ad4da891e
PAMJA	de8143e950b57808671267b2aaa50de39fa3cf69cf00beb30eb19ff151174fd5

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d20a513c6ba92742213c17a40a5d41c7d9f531c0be1ec79af39a88799a9041cb
E MËPARSHMJA	d6db398bb18de9cf50921975b044923f4d8f0e9ea00364848e29e63619e428ac
RRËNJA MERKLE	6fb9c5db00d56eb16d7b89509f6753e0d73cfa2b6c12b8ba1cfb6a7dfb21a7a6
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d20a513c6ba92742213c17a40a5d41c7d9f531c0be1ec79af39a88799a9041cb>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

3 ORE ME PARE

110 ditë qëndresë/ Pas protestës para Kuvendit qytetarët mbledhën sërish në Bulevard: Arrestoni Ramën!

9 ORE ME PARE

Vendimi i Hagës nxiti protesta dhe reagime në Kosovë/ PDK mbledh Kryesinë, familjarët: Gjykatë kriminale, presim pafajësi në Apel

13 ORE ME PARE

Pagat e magistratëve, PS propozon rritje sa 2% e pagës së Presidentit! Rama shkon në Kuvend. Bardhi: Puç kushtetues

13 ORE ME PARE

"Nuk na përfaqësoni"/ Qytetarët protestojnë pranë Kuvendit, përplasen me policinë, shoqërohen disa prej tyre

LIVE UPDATES

Pagat e magistratëve, PS propozon rritje sa 2% e pagës së Presidentit! Rama shkon në Kuvend. Bardhi: Puç kushtetues

• Seanca plenare e Kuvendit është shoqëruar me debate mes mazhorancës dhe opozitës për pagat e magistratëve, vendimin e Gjykatës Speciale në Hagë për ish-krerët e UÇK-së dhe protestën jashtë Parlamentit. • Në nisje të seancës, kryetari i Kuvendit, Niko Pelesh, e cilësoi të dhimbshëm vendimin e Hagës dhe njoftoi për përgatitjen e një deklarate të përbashkët të Kuvendit. • Ndërsa deputetët e PD-së u paraqitën me simbole të UÇK-së dhe kërkuar miratimin e rezolutës për gjenocidin serb në Kosovë. • Një tjetër përplasje u zhvillua për projektligjin mbi statusin e magistratëve. • Gazment Bardhi kërkoi tërheqjen e tij nga rendi i ditës, duke akuzuar mazhorancën se nuk ka zbatuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese për pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve. • Nga PS-ja ishte Taulant Balla që kundërshtoi kërkesën dhe deklaroi se mazhoranca do të votojë kundër saj. • Debate pati edhe për protestën jashtë Kuvendit, pasi deputeti i Lëvizjes Bashkë, Redi Muçi, kritikoi mazhorancën për dhunën ndaj qytetarëve. • Debat pati edhe për KAYO-n, me kryedemokratin Sali Berisha që akuzoi mazhorancën se po mbron Edi Ramën dhe Ron Yeffet-in dhe se po i jepen para kompanisë përmes kontratave shtetërore. • Deputeti i PD-së, Luçiano Boçi, ngriti shqetësimin për përfshirjen e shkollave me më pak se 21 nxënës në testimin PISA 2025, ndërsa ministrja Mirela Kumbaro tha se përzgjedhja është bërë sipas metodologjisë së OECD-së. • Ndërsa në interpelancën për shëndetësinë, ministrja Klodiana Spahiu premtoi se PET Scan-i do të jetë në Onkologjik në janar 2027, duke deklaruar se në të kundërt do të japë dorëheqjen.

28 artikuj për këtë temë.

1 ORE ME PARE

"Një prokuror rrethi dërgoi OPGJ-në në degën e Thesarit"/ Malaj: U tha punonjësve ekzekutoni pagesat, ose do ju arrestojmë



Petrit Malaj

TIRANË- Ministri i Financave, Petrit Malaj, ka deklaruar në Kuvend se një prokuror rrethi ka dërguar oficerin e policisë

editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

AKTUALITET 17 SHTATOR 2026, 22:14

Sherri mes të rinjve në Sarandë/ Dalin PAMJET nga vendi i ngjarjes, njëri prej autorëve tenton t'i ngulë thikën në asf

gjyqësore në dëgen e thesarit dhe sipas tij, u ka mienë punonjësve të ekzekutivëve pagat ose do t'i arresojë. Gjate t'jares se tij në seancën plenare, Malaj tha se Thesari verifikon a ka bazë ligjore dhe nëse gjithçka është e rregullt pagesat kalojnë.

"Një prokuror rrethi dërgoi OPGJ në degën e Thesarit dhe ju tha punonjësve ose ekzekutoni pagesën ose do t'ju arresojmë. Ku ndodh kjo? Kjo nuk është matje muskush, mund të më thonë ku është shkëlja që ka bërë punonjësi i thesarit apo ministri i Financave? Është bërë kallëzim për këtë çështje. Thesari verifikon a ka bazë ligjore, nëse gjithçka është e rregullt pagesa normalisht kalon. Ky mekanizëm mbron paratë publike", tha ministri Malaj në Kuvend./Dosja.al

1 ORE ME PARE

"Nisma të tilla kërkojnë mendimin e Këshillit të Ministrave"/ Manja: Kjo që ju bëni për pagat e gjyqtarëve, është politike



Ulisi Manja

TIRANA- Deputeti i Partisë Socialiste Ulisi Manja, deklaroi në Kuvend se qeveria nuk ka ndërmarrë asnjëherë hapa për uljen e pagave të magistratëve. Sipas tij, debatet e zhvilluara në Gjykatën Kushtetuese kanë pasur në fokus nivelin e rritjes së pagave për gjyqtarët dhe prokurorët.

Në fjalën e tij, Manja nënvizoi se garantimi i pavarësisë financiare të sistemit të drejtësisë mbetet i rëndësishëm, por shtoi se Kuvendi duhet të marrë parasysh edhe nevojën për administrimin dhe përdorimin e përgjegjshëm të financave publike.

"Nisma të tilla që prekin buxhetin e shtetit kërkojnë mendimin e Këshillit të Ministrave. Ka një pretendim këtu se nisma që do votojmë këtu është tërësisht e ndryshme nga varianti fillestar i depozituar nga nismëtarët. Jo të nderuar kolegë. Kjo që ju bëni këtu se ju qan shpirti për pagat e gjyqtarëve e prokurorëve, është politike. Është e vërtetë se pas miratimit në vitin 2016 kemi shkuar disa herë në Kushtetuese, por asnjëherë nuk kemi shkuar si një përplasje mes legjislativit e gjyqësorit, por për masën e rritjes së pagave e prokurorëve. Mazhoranca nuk ka bërë ulje të pagave për magistratët. Pavarësia financiare e sistemit të Drejtësisë është e rëndësishme, por edhe përgjegjësia e menaxhimit të financave publike është shumë e rëndësishme për Kuvendin e Shqipërisë", tha Manja./Dosja.al

1 ORE ME PARE

"Është një debat aspak fisnik"/ Bylykbashi për pagat e magistratëve: Këta kanë ardhur me projekt gjigant për të grabitur shqiptarët, janë interesa miliarda



POLITIKE 17 SHTATOR 2026, 20:56

Rastësi apo? Ditën që u shpallën fajtor ish-krerët e UÇK-së, Rama viziton Manastrin me lidhje serbe në Malin Athos

POLITIKE 17 SHTATOR 2026, 19:07

"U përshëndetëm me shenjë tonë sekrete"/ Djali i Kadri Veselit rrëfen momentet para dhe pas vendimit në Hagë: Besojmë se Apeli do ta korrigjojë vendimin

më të klikuarat

Regjistruan 1143 hektarë me dokumente fals/ Arrestohen dy ish-drejtorë dhe juristi i ASHK Fier, në pranga edhe një punonjës (EMRAT)

Falsifikime dhe shpërdorim detyre/ Pezullohen dy zyrtarë në Tiranë, shpallet në kërkim shqiptaro-izraeliti me tre identitete

Kontrolle në burgjet e Peqinit dhe Fierit/ Kapen celularë, arrestohet një i burgosur dhe procedohen 9 persona

Shkatërrohet organizata shqiptare që frymëzoi serialin e famshëm 'Marbella'/ Kapen 2.7 ton kokainë, sekuestrohen dy armë zjarri dhe 29 mjete luksoze, 15 persona të arrestuar (VIDEO)

insights

Auron Janku

Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen



Oerd Bylykbashi

TIRANA- Deputeti i Partisë Demokratike Oerd Bylykbashi, gjatë fjalimit të tij në seancën e sotme plenare e ka cilësuar debatin mes qeverisë dhe institucioneve të Drejtësisë për pagat e magjistratëve si aspak fisnik, në një moment kur një pjesë e popullsisë po kalojnë një krizë të thellë ekonomie.

Në fjalën e tij, ai theksoi se qeveria po shkel vendimin e Gjykatës Kushtetuese për pagat e magjistratëve, ndërsa shtoi se kjo përplasje do të çojë në 'ndarjen e pushteteve', gjë që sipas tij do të fitohet nga magjistratët.

"Debati për pagat e gjyqtarëve është një debat aspak fisnik, në një moment që në shesh ka njerëz që nuk u del pensioni, nuk u dalin pagat dhe nuk mbyllin dot muajin. Kur na dëgjojnë, shkulin qimet e kokës. Por gjithësesi ky nuk është një diskutim populist. Ka disa që thonë ku do i gjejmë paratë për pagat e magjistratëve. Mjafton që të kursejmë masakrën e buxhetit publik që po i bëni përditë me modelin korruptiv që keni dhe ka para jo për magjistratët, por për t'ja rritur pagën të gjithë atyre që shërbejnë në administratë. S'ka njeri që nuk e di se çfarë vjedhje gjigande me milionë euro keni bërë ju me këto koncesione e PPP. Modeli KAYO Yeffet është kulmi. Këta kanë ardhur me projekt gjigant për të grabitur shqiptarët me breza. Janë interesa miliarda.

Që ta kesh këtë gjë, duhet të kapësh pushtetet. Sot s'ka gjyqtarë, janë mbi 200 mijë çështje që rrijnë nëpër gjykatë. Janë më shumë se gjysmë milioni në çështje gjyqësore. Pra ¼ e popullsisë. Kjo është drejtësia që prodhoi në dhjetë vite Reforma në Drejtësi. Ajo që ju sot doni të votoni është në shkëlqim flagrante të vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Në këtë përballje, që nuk është një konflikt kushtetues, por një krizë kushtetuese e qëllimshme e shkaktuar nga Rama. Por këtë krizë do e fitojnë gjyqtarët e prokurorët. Në këtë krizë do definojnë diçka shumë e rëndësishme, ndarja e pushteteve, kontrolli e balanca. Unë preferoj të keqen më të vogël, mbështes gjyqtarët e prokurorët. Ka ardhur koha të zhbëjmë këtë kontroll totalitar mbi çdo aspekt të jetës së këtij vendi. Të krijojmë ishujt e pavarësisë. Çështja do shkojë sërish në Kushtetuese, s'keni zgjidhje tjetër", tha Bylykbashi./Dosja.al

1 ORE ME PARE

Pagat e magjistratëve/ Gogu: Kuvendi miraton ndryshimet ligjore, jo qeveria



Toni Gogu

TIRANA- Ministri i Drejtësisë Toni Gogu, tha ditën e sotme në Kuvend se pagat e magjistratëve përcaktohen përmes ligjit dhe nuk mund të vendosen nga vetë qeveria. Njëkohësisht, ai pranoi se afati i 31 korrikut për ndërhyrjet ligjore lidhur me këtë çështje tashmë ka përfunduar.

Gjatë fjalës së tij, Gogu deklaroi se skema e re parashikon rritjen e koeficientit të pagës, ndërsa mbetet në fuqi edhe mekanizmi i indeksimit. Sipas tij, Kuvendi ka detyrimin të mbrojë pavarësinë e sistemit të drejtësisë, duke garantuar njëkohësisht që fondet publike të përdoren me përgjegjshmëri.

"Sot Kuvendi i Shqipërisë ka dy detyra, nuk ka një, ka dy detyra. Nga njëra anë duhet të mbrojë pavarësinë e sistemit të drejtësisë, gjyqësorit, dhe nga ana tjetër duhet të mbrojë çdo qindarkë të qytetarëve shqiptarë, të cilët paguajnë për atë drejtësi. Afatin e 31 korrikut e kemi thënë në komision që ka kaluar. Prandaj kjo shumicë ka ardhur sot të mbushë atë boshllëk që ka krijuar kalimi i atij afati. Nuk ka ardhur ta komentojë, nuk ka ardhur ta anatemojë, nuk ka ardhur ta mallkojë, ka ardhur ta mbushë atë boshllëk. Dhe sot ka një ligj përpara këtij Kuvendi, të paraprirë dhe të udhëhequr nga një pyetje, nga pyetja e duhur: Kush vendos për pagat e gjyqtarëve? Dhe nuk e ka shpikur pyetjen. E ka marrë tamam nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese, i cili zbërthen parimin kushtetues dhe shkruan: detyrimi i Kuvendit të miratojë ndryshimet ligjore të nevojshme. Jo i qeverisë, jo i këshillave, jo i ministrit të Drejtësisë, detyrimi i këtij Kuvendi.

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Moti

Powered by tomorrow.

Paga e gjyqtarit kalon vetëm nga një derë. Paga e magjistratit kalon vetëm nga një derë. Paga e doktorit kalon vetëm nga një derë. Paga e infermierit kalon vetëm nga një derë. Paga e zjarrfikësit kalon vetëm nga një derë. Dhe ajo derë është ligji. Ligji. Ky është parimi që ka ndjekur kjo shumicë sot me atë projekt që ka ardhur dhe rregulli bazë që ka ndërtuar gjithë arkitekturën e pagave në këtë republikë është: askush nuk duhet të ketë diskrecionin t'ia caktojë vetes pagën e vet. Sepse kur dikush i cakton vetes pagën e vet, nuk është më një rregull i përgjithshëm, por është një përjashtim. Buxheti i shtetit nuk është ai dollapi me shumë sirtarë ku secili institucion ka sirtarin e vet. Ka vetëm një arkë dhe ajo arkë është e qytetarit shqiptar. Nuk është arka as e ministrave, as e qeverisë, as e gjyqtarëve apo e doktorëve. Është arka e qytetarëve shqiptarë, që e ruan ky Kuvend dhe e ruani ju, të nderuar kolegë", tha Gogu./Dosja.al

2 ORE ME PARE

"Një puç kushtetues"/ Bardhi: Drafti i PS-së shkel vendimin e Kushtetueses, do të votojmë kundër



Gazment Bardhi

TIRANË- Kreu i grupit parlamentar të PD-së Gazment Bardhi, ka dalë kundër projektligjit të PS-së për pagat e magjistratëve, duke e konsideruar atë si një 'puç kushtetues'.

Gjatë fjalës në Kuvend, Bardhi akuzoi qeverinë se po injoron për herë të tretë vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe se po dobëson garancitë financiare për gjyqtarët dhe prokurorët.

Sipas Bardhit, mënyra e re e llogaritjes së pagave nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga Kushtetuesja. Ai deklaroi se Partia Demokratike do të votojë kundër projektligjit.

"Projektligji që po diskutojmë sot nuk ka të bëjë as vetëm me gjyqësorin, as vetëm me legjislativin dhe as vetëm me ekzekutivin. Ka të bëjë me shtetin shqiptar, ka të bëjë me sistemin institucional dhe kushtetues të Republikës së Shqipërisë. Ju nuk keni vendosur të sfidoni gjyqësorin, por të sfidoni shtetin shqiptar, të sfidoni rendin kushtetues në vend. Shkurt, keni vendosur të vazhdoni një puç kushtetues të nisur që prej vitit 2017 lidhur me këtë çështje.

Gjyqtarët dhe prokurorët nuk po kërkojnë rritjen e pagës së tyre. Nëse do të kërkonin një rritje të re të pagës, nuk do të kishin as mbështetjen e grupit parlamentar të Partisë Demokratike. E vërteta është se prokurorët dhe gjyqtarët e Republikës po kërkojnë të marrin pagën që ky Kuvend ua përcaktoi në vitin 2016", tha Bardhi./Dosja.al

2 ORE ME PARE

Pagat e magjistratëve/ Aulona Bylykbashi prezanton ndryshimet e propozuara: Rritje sa 2% e pagës së Presidentit





Kuvendi

TIRANË- Deputetja e PS-së Aulona Bylykbashi, ka prezantuar në Kuvend ndryshimet e propozuara për pagat e magistratëve, duke bërë të ditur se koeficienti do të rritet nga 0.36 në 0.38 të pagës së Presidentit.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.